

ovik. Në datën **29.07.1998**, ai me disa miq kanë shkuar në fshatin fqinj të **Krushecit/Kruševac**. Atë ditë, në Krushec/Kruševac zhvilloheshin luftimet e ashpra ndërmjet forcave të UÇK-së dhe atyre serbe. Pranë Idrizit ka rënë një granatë që nuk eksplodoi. Ai e mori me qëllim që ta çonte në shtab të UÇK-së, por ajo i eksplodoi në dorë. Ka dhënë shpirt në vend. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur në varrezat e Dubovikut/Dubovik.

Burimi: deklarata N.S, FDH-17079.

Qemal (Mustafë) Gashi

(1959, shqiptar nga Peja/Peć, këpucëtar, i martuar)

Qemali punonte në *Kombinatin e Lëkurës dhe Këpucëve* në Pejë/Peć. I biri Medini ka qenë i fundit që e shihte Qemalin të gjallë në shtabin e UÇK-së, në shkollën lokale në **Baran, nga fundi i muajit korrik të vitit 1998**. Në muajin shtator të vitit 1998, trupi i Qemalit u gjet në kanalën e *Liqenit të Radoniqit/Radonjičko jezero*. Obduksioni ka konstatuar se Qemalin e kanë privuar nga jeta duke e qëlluar me armë zjarri në komblik. Mbetjet e tij mortore i janë dorëzuar familjarëve më 18.09.2006. godine.

Burimet: ICTY, IT-04-84 (R. Haradinaj dhe të tjerë), transkript, 25.05.2007, FDH-34613; ICTY, IT-04-84 (R. Haradinaj dhe të tjerë), transkript, 29.05.2007, FDH-34614; ICTY, IT-04-84 (R. Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi\(-IT-04-84-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi(-IT-04-84-);) deklarata S.H, FDH-35272; OMPE, *Mbetjet*, FDH-15297.

Zenun (Ramadan) Gashi

(8.08.1957, egjiptian nga Kosuriq/Kosurić, komuna e Pejës/Peć, pensionist, shtatë fëmijë)

Para pensionimit, Zenuni punonte në SPB-në e Pejës/Peć. Me bashkëshorten Sabrijen, tre fëmijë dhe të ëmën jetonte në Kosuriq/Kosurić. Në verën e vitit 1998, pjesëtarët e UÇK-së disa herë kishin shkuar te Zenuni për të kërkuar armë dhe bastisur shtëpinë e tij. Në datën **1.08.1998**, nga ora 11:00, në shtëpinë e tij erdhën katër pjesëtarë të UÇK-

së dhe e morën për bisedë informative me komandantin lokal të UÇK-së. E çuan në shtabin e UÇK-së në **Baran**. Po atë ditë, një pjesëtar i FARK-ut e kishte parë Zenunin në Baran. Ishte i topitur nga rrahjet e rënda dhe gjendej në një makinë nën përcjelljen e katër ushtarëve të UÇK-së. Trupi i Zenunit u gjet më 11.09.1998 në kanalën e *Liqenit të Radoniqit/Radonjičko jezero*. Sipas gjetjeve të obduksionit, Zenunin e kishin vrarë me plumba në kokë. Pushteti serb e kishte varrosur Zenunin, së bashku me të gjithë personat e tjerë të pidentifikuar, në varrezat e fshatit Piskotë/Piskot [komuna e Gjakovës/Đakovica]. Familja e Zenunit, pas kthimit nga mërgimi në muajin shtator të vitit 1999, e ka paraqitur zhdukjen e tij. Në datën 21.09.2005, familjarët kanë mësuar zyrtarisht se trupi i Zenunit ishte identifikuar. Dy ditë më vonë, familjarët i kanë marrë mbetjet e tij mortore dhe i kanë varrosur në varrezat e Vitomiricës/Vitomirica.

Burimet: deklarata S.G, FDH-19714; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, XVIII, 267; USCG KGDH, *Registri..*, FDH-8817; KNKK, *Persona të zhdukur..*, FDH-9795; KMKRFJ, *Personat..*, FDH-10832; Z. Stijović, *Kosmet..*, 108, 109; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 350; ICTY, IT-04-84 (R. Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi\(-IT-04-84-\);](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi(-IT-04-84-);) ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298.4 (1,2), FDH-30903.

Branislav (Slobodan) Nikolić

(8.04.1974, serb nga Shabaci, i pamartuar, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Pas mbarimit të shkollës së mesme dhe trajnimit për oficer policie, Branislavi u punësua në Shërbimin e Sigurimit Shtetëror, në muajin nëntor të vitit 1997. Ka qenë pjesëtar i Njësitit për Veprime Speciale. U plagos më **10.08.1998**, gjatë përleshjes me forcat e UÇK-së që u zhvillua në rrugë **Pejë/Peć** – Istog/Istok. Ka ndërruar jetë një ditë më vonë, më 11.08.1998.

Burimet: KMKRFJ, *Personat..*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 48, 49; Z. Stijović, *Kosmet..*, 110; M. Sekulić, *Beograd..*, 67; *Ovo*